

Metodat e Sigurimit të shtetit shqiptar, aspekte teorike e praktike të tyre dhe krahasimi me vendet e tjera ish-komuniste

Dr. Ardian Elezi

BIO

Doktor i shkencave historike, me profil në gjeopolitikë. Gjatë karrierës së tij akademike ka shërbyer si pedagog në disa institucione të arsimit të lartë në Shqipëri, përfshirë Kolegjin Universitar “Qiriazi” dhe Universitetin “Luarasi”. Veprimtaria e tij kërkimore fokusohet në studimin e krimeve të komunizmit, luftës së klasave dhe gjenocidit të pandëshkuar ndaj shqiptarëve, tema për të cilat ka kontribuar me një sërë botimesh dhe prezantimesh në konferenca shkencore kombëtare dhe ndërkombëtare. Dr. Elezi është i angazhuar aktivisht në nxitjen e debatit historik dhe promovimin e të vërtetës mbi të kaluarën komuniste në Shqipëri.

Abstrakt

Diktatori Hoxha dhe regjimi komunist e shihte mbajtjen e pushtetit si qëllim në vetëvete, ku i përfshirë në vorbullën e përplasjeve diktomike dhe interesave gjeostrategjike e gjeopolitike mes fuqive të kohës, perëndimit nga njëra anë dhe bllokut lindor ku ishte përfshirë ideologjikisht nga ana e tjetër tentoi ta mbante atë me çdo kusht dhe mjet e mënyrë.

Duke përdorur instrumenta represioni e terrorit, duke shtuar frikë dhe pasiguri, ashpërsuar luftën e klasave, asgjësimin e kundërshtarëve qoftë brenda llojit të vet, por edhe atyre që i kishte targetuar si armiku dhe kundërshtarë të pushtetit të vet që në krye të herës me ardhjen e tij në pushtet, të tilla të etiketuar si kategori e armiqëve të popullit, e kulakëve, e shtresave intelektuale e patriotike të cilat kishin një kontribut historik e formim perëndimor që binin ndesh me ideologjinë e filozofinë e komunistëve, ato shiheshin si kundërshtar potencial të rregjimit të tij dhe si të tillë kanë qenë gjithnjë target i goditjeve, survejimit, burgosjes, etj

Mekanizmat e terrorit, metodat e instrumentat e përdorur përmes armës së sigurimit të shtetit që e kontrollonte për qëllimet e mbajtjes së pushtetit të vet ishin të shumta Sigurimi dhe rrjeti informativ i ngritur synonte garantimin e pushtetit të tij absolut, kontrollin total të shoqërisë si dhe vet partinë që e drejtonte gjithashtu.

Kjo strukturë mbrujti dhe zbatoi metodat nga ato më artizanale, të permendura si të tilla edhe nga dëshmitë e zërat e shumtë të kujtesës në memoriet e tyre dhe deri ato më moderne sipas modelit të simotrave frymëzuese të strukturave lindore, KGP.ej, ku qoftë në aspektin teorik po ashtu edhe ai i zbatimit praktik merrej si referencë madje tejkaloheshin në ekstreme të papara dhe padëgjura për brutalitetin e tyre gjatë zbatimit praktik. Ky rrjet i

ngritur me hir a me pahir, me metoda joshëse dhe shtrënguese, në jo në pak raste dekonspirohesh gjatë përcaktimit të vijës së sjelljes dhe zbatimit të saj, detyrave dhe orientimeve të kërkuara, mbledhjes së “provës ligjore” për atribuimin e vërtëtimin e akuzës të ngritura në dëm të akuzuarëve apo të dushuarëve të targetuar gjatë proceseve hetimore gjyqsore për tu dënuar. Ky punim synon gjithashtu të analizojë nga njëra anë dhe njeherazi të krahasojë metodat e përdorura nga ana e Sigurimit të Shtetit në Shqipëri me ato të shërbimeve të sigurimit në vende të tjera ish-komuniste, si Bashkimi Sovjetik, Gjermania Lindore etj. Studimi fokusohet në mekanizmat e survejimit, kontrollit social, represionit politik dhe ndikimit të tyre në vendin tonë. Përmes një qasjeje krahasuese, evidentohen ngjashmëritë strukturore, por edhe veçoritë specifike të modelit shqiptar, i cili karakterizohet nga izolimi ekstrem dhe kontrolli total mbi individin, shoqërinë. Synimi i kësaj përsiatjeje është që në mënyrë jo shteruese, i bindur për limitet e saj për shkak dhe burimeve të kufizuara dhe natyrës hermetike e diskrete e punës së kësaj strukture, të tentohet të jepet një qasje diakronike në rrafshin institucional dhe funksional të mënyrës së organizimit të kësaj strukturë, rrjetin e ngritur, kontigjenteve dhe kategorizimin e bërë, ruajtjen nga dekonspirimi dhe praktikave të ndjekura lidhur me drejtimin e kordinimit me to, paraqitja e së cilës do të tentohet të përplotesohet në mynyrë sinkronike e parë në këndvështrimin e dinamikave kohore dhe historike me ndonjë shembull praktik të punës së tyre.

Fjalë kyçe: *Sigurimi i Shtetit, komunizëm, survejim, represion, shtet totalitar, rezidentura etj*